

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.9 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokollit 8648/24; dhe Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional të Inxhinierëve të Licencuar të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokollit 8655/24, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 07.04.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Programi i Edukimit të Vazhdueshëm Profesional për vitin 2026 për anëtarët e licencuar të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, sipas Programit të bashkangjitur, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inženjera Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo			
Nr. i Prot. Broj Prot.	<u>221/26</u>	Nr. i Prot. Broj Prot.	<u>221/26</u>
Org. Jedinstva Org. Unit	<u>OIRK</u>	Prot. No.	<u>221/26</u>
Nr. ifaqove Br. Stranica		Data: Datum:	<u>07.04.26</u>
Nr. Pages		Date:	<u>07.04.26</u>
PRISHTINË / A			No.1

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së 
2. **Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së 
3. **Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së 
4. **Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së 
5. **Nebi Pllana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
6. **Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
7. **Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së 



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**PROGRAMI I EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL
PËR VITIN 2026**

(Periudha: 01 janar 2026 – 31 dhjetor 2026)



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, Statutit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës dhe Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional të Inxhinierëve të Licencuar, e cila përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e organizimit të aktiviteteve të edukimit profesional dhe sipas së cilës Programi miratohet nga Bordi Drejtues i Odës, si dhe duke u bazuar në nevojat reale të zhvillimit të profesionit dhe disiplinave përkatëse inxhinierike,

Bordi Drejtues i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës miraton:

PROGRAMIN E EDUKIMIT TË VAZH DUESHËM PROFESIONAL PËR VITIN 2026

Neni 1 – Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Programi është zhvillimi dhe avancimi i kapaciteteve profesionale të inxhinierëve të licencuar në Republikën e Kosovës, në përputhje me standardet bashkëkohore të inxhinierisë dhe kërkesat e tregut.
2. Programi synon:
 - përmirësimin e cilësisë në projektim, zbatim dhe mbikëqyrje të punimeve;
 - avancimin e njohurive teknike sipas standardeve evropiane (Eurocode, EN, ISO);
 - forcimin e kapaciteteve në menaxhimin e projekteve dhe kontratave ndërkombëtare;
 - rritjen e kompetencave në përdorimin e teknologjive moderne dhe sistemeve të automatizuara;
 - sigurimin e edukimit të vazhdueshëm profesional si kusht për ruajtjen e licencës.

Neni 2 – Fushëveprimi

1. Ky Program zbatohet për Odën e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, organet e saj dhe të gjithë anëtarët e licencuar të Odës.
2. Programi përfshin aktivitetet profesionale në këto fusha:
 - inxhinieri e ndërtimit (konstruktiv, hidroteknikë, gjeologji, gjeoteknikë, infrastrukturë, gjeodezi);
 - mbikëqyrje dhe kontroll teknik i punimeve;

- menaxhim kontratash dhe projekte (FIDIC);
 - elektroteknikë dhe sisteme energjetike;
 - makineri, automatizim dhe sisteme industriale.
3. Programi mund të përfshijë edhe pjesëmarrës të tjerë sipas vendimit të Bordit Drejtues.

Neni 3 - Struktura dhe përmbajtja e Programit

1. Programi përbëhet nga aktivitete të edukimit të vazhdueshëm profesional, të strukturuar në forma si:
 - trajnime profesionale dhe seminare;
 - ligjërata tematike dhe punëtori;
 - analiza të rasteve praktike dhe studime të projekteve;
 - prezantime të standardeve teknike dhe rregullative.
2. Përmbajtja e Programit përfshin temat kryesore si:
 - projektimi sipas Eurokodeve dhe standardeve EN;
 - vlerësimi dhe rehabilitimi i strukturave ekzistuese;
 - menaxhimi i rrezikut nga vërshimet dhe ndryshimet klimatike;
 - themelet e thella dhe zgjidhjet gjeoteknike;
 - menaxhimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore;
 - piktetimi dhe monitorimi gjeodezik;
 - mbikëqyrja inspektuese dhe kontrolli i cilësisë;
 - rregulloret dhe funksionimi i Odës;
 - kontratat FIDIC dhe menaxhimi kontraktual;
 - sistemet elektroenergjetike, digjitalizimi dhe energjia e ripërtëritshme;
 - automatizimi industrial, HVAC dhe infrastruktura moderne.
3. Temat, kohëzgjatja dhe përmbajtja e detajuar e aktiviteteve paraqiten në tabelat përkatëse të këtij Programi.

Neni 4 – Përputhshmëria me Rregulloren për EVP

1. Programi i Edukimit të Vazhdueshëm Profesional për vitin 2026 është hartuar në përputhje me Rregulloren për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional të Inxhinierëve të Licencuar, sipas së cilës çdo inxhinier i licencuar është i obliguar të realizojë minimum tetë (8) pikë kredituese gjatë vitit kalendarik, si kusht për ruajtjen e licencës.
2. Programi është strukturuar në atë mënyrë që të përmbajë aktivitete të edukimit të vazhdueshëm profesional me një total minimal prej njëzet (20) pikë kredituese në nivel programi vjetor, në përputhje me kërkesat e rregullores.
3. Në përputhje me këtë kërkesë, Programi siguron që së paku një e treta (1/3) e aktiviteteve të jenë nga fusha teknike-rregullative (legjislative), duke përmbushur kriteret e përcaktuara në rregullore.

4. Programi gjithashtu përfshin aktivitete që realizohen në formë online, në përputhje me kufizimet dhe kërkesat e rregullores për organizimin e edukimit të vazhdueshëm profesional.
5. Me qëllim përfshirjen e të gjitha fushave profesionale dhe ofrimin e mundësisë për zgjedhje fleksibile nga ana e pjesëmarrësve, Programi përmban gjithsej katërdhjetë e tetë (48) pikë kredituese, duke tejkaluar minimumin e kërkuar sipas rregullores, pa cenuar detyrimin individual për përmbushjen e minimumit të pikëve kredituese nga ana e inxhinierëve.

Neni 5 - Parimet e zbatimit

1. Programi zbatohet në përputhje me këto parime:
 - ligjshmëria dhe përputhshmëria me legjislacionin në fuqi;
 - profesionalizmi dhe cilësia teknike;
 - transparenca dhe barazia e pjesëmarrjes;
 - relevanca praktike dhe aplikueshmëria në terren;
 - harmonizimi me standardet evropiane dhe praktikrat ndërkombëtare.
2. Programi siguron balancë ndërmjet përmbajtjes teorike dhe asaj praktike.

Neni 6 - Përgjegjësitë për zbatimin e Programit

1. Bordi Drejtues i Odës është përgjegjës për:
 - miratimin e Programit;
 - mbikëqyrjen e zbatimit të tij;
 - sigurimin e cilësisë së aktiviteteve;
 - bashkëpunimin me ekspertë dhe institucione relevante.
2. Administrata e Odës është përgjegjëse për organizimin dhe realizimin e aktiviteteve, duke përfshirë koordinimin, logjistikën dhe evidencën e pjesëmarrësve.
3. Programi zbatohet në përputhje me Rregulloren për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional dhe aktet tjera të Odës.

Neni 7 – Ligjëruesit dhe organizimi i aktiviteteve

1. Ligjëruesit e angazhuar në kuadër të Programit përcaktohen sipas fushave profesionale dhe përmbajtjes së temave përkatëse. Për një pjesë të aktiviteteve ligjëruesit janë tashmë të përcaktuar, ndërsa për temat tjera, ku angazhimi është në proces ose nuk është finalizuar ende, ligjëruesit do të caktohen në kohë, në përputhje me ekspertizën dhe nevojat profesionale të secilës fushë.

Bordi Drejtues i Odës rezervon të drejtën që, në rast të pamundësisë së ndonjë ligjëruesi për të realizuar aktivitetin e planifikuar, të bëjë zëvendësimin ose ndryshimin e ligjëruesit, duke siguruar nivel të njëjtë të ekspertizës dhe cilësisë së trajnimit.

2. Bordi Drejtues i Odës, në bashkëpunim me Administratën, është përgjegjës për planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të Programit, duke përcaktuar orarin dhe kohën e mbajtjes së tyre në mënyrë të përshtatshme gjatë vitit kalendarik.
3. Pjesëmarrësit do të njoftohen me kohë për orarin dhe planifikimin e aktiviteteve, ndërsa Bordi Drejtues do të marrë parasysh edhe numrin e madh të anëtarësisë, me qëllim sigurimin e një organizimi sa më të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës.
4. Të gjitha aktivitetet e parapara në këtë Program do të realizohen brenda vitit përkatës, në përputhje me planifikimin dhe kapacitetet organizative të Odës.

1. Programi i edukimit të vazhdueshëm profesional

1.1 Fushat profesionale të rregullativës teknike dhe ligjore në ndërtim

Numri rendor	1
Titulli i trajnimit	Mbikqyrja Inspektuese
Përshkrim i shkurtër	Trajnimi në fushën e mbikëqyrjes inspektuese trajton rolin dhe përgjegjësitë e inxhinierit mbikëqyrës në projektet ndërtimore, duke u fokusuar në bazën ligjore dhe zbatimin e udhëzimeve administrative në fuqi. Në kuadër të trajnimit do të shtjellohet përputhshmëria e punimeve me projektin dhe specifikimet teknike, kontrolli i cilësisë së materialeve dhe ekzekutimit, si dhe procedurat e testimeve dhe inspektimeve gjatë realizimit të projektit. Gjithashtu, trajtohen aspektet e menaxhimit të progresit, kohës dhe kostos, dokumentimi dhe raportimi profesional, si dhe kërkesat mjedisore dhe procedurat për inspektimet finale dhe lejes së përdorimit të objekteve.
Mënyra e mbajtjes	Online
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha e rregullativës teknike dhe ligjore
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Dr. sc. Ilir Rodiqi; Prof. Asoc. Dr. Esat Gashi; Inxh. Dipl. Enver Bytyqi; Ramë Hamza, Inxh. Ark.
Numri rendor	2
Titulli i trajnimit	Rregulloret e OIRK-së
Përshkrim i shkurtër	Trajnimi për Rregulloret e OIRK-së trajton kornizën ligjore dhe funksionale të Odës, duke përfshirë organizimin, kompetencat, funksionimin e strukturave drejtuese dhe rolin përfaqësues të saj, si dhe Rregulloren e punës së Kuvendit. Në kuadër të trajnimit shtjellohen proceset e licencimit dhe ri-licencimit, kategoritë e anëtarësisë, të drejtat dhe përgjegjësitë profesionale të anëtarëve, standardet etike, përgjegjësia disiplinore, edukimi i vazhdueshëm profesional, tarifatat dhe taksat, sigurimi profesional, si dhe

	funksionimi i administratës dhe menaxhimi i regjistrave zyrtarë. Gjithashtu, trajtohen procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencave, njohjen e licencave të huaja dhe regjistrimin e inxhinierëve praktikantë, me qëllim sigurimin e një kuptimi të plotë dhe të unifikuar të funksionimit të profesionit dhe të Odës.
Mënyra e mbajtjes	Online
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha legislative
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Rinor Hoxha, jur. dipl.
Numri rendor	3
Titulli i trajnimit	Kontratat FIDIC
Përshkrim i shkurtër	Trajnimi për kontratat FIDIC synon avancimin e kapaciteteve profesionale në menaxhimin dhe zbatimin e kontratave ndërkombëtare në projektet ndërtimore. Në kuadër të tij trajtohet interpretimi dhe zbatimi korrekt i dispozitave kontraktuale, procedurat për ndryshime, pagesa dhe njoftime, si dhe menaxhimi i kohës, kostos dhe cilësisë. Gjithashtu, trajtohen çështjet që lidhen me shmangien e keqinterpretimit të kontratave, reduktimin e rreziqeve për mosmarrëveshje, kërkesa (claims) dhe procese arbitrazhi, si dhe përputhshmëria me kërkesat e institucioneve financuese ndërkombëtare, me qëllim forcimin e rolit të profesionistëve vendorë në të gjitha fazat e projekteve.
Mënyra e mbajtjes	Online
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha legislative
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Dr. sc. Ilir Rodiqi; Prof. Asoc. Dr. Esat Gashi; Inxh. Dipl. Zyber Gaga

1.2 Fushat profesionale dhe temat e trajnimeve në inxhinierinë e ndërtimit

Numri rendor	1
Titulli i trajnimit	Aplikimi i metodave të vlerësimit të materialeve të strukturave ekzistuese si dhe aplikimi i metodave dhe materialeve inovative
Përshkrim i shkurtër	Kjo temë trajton vlerësimin e materialeve dhe cilësisë në strukturat ekzistuese prej betoni, në përputhje me standardin EN 13791. Përfshihen metodat e vlerësimit vizual, si dhe metodat destruktive dhe jodestruktive të testimit, me fokus në interpretimin dhe krahasimin e rezultateve. Trajtohet konformiteti i betonit në strukturë dhe përcaktimi i masave për sanim dhe përforcim bazuar në rezultatet e vlerësimit. Gjithashtu, prezantohen qasje bashkëkohore në trajtimin e strukturave ekzistuese, përmes përdorimit të materialeve dhe teknikave inovative, përfshirë materialet kompozite (FRP) dhe zgjidhjet moderne për përforcim dhe rehabilitim, duke reflektuar zhvillimet e fundit në praktikën inxhinierike.

Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Prof. Dr. Naser Kabashi; MSc. Enes Krasniqi
Numri rendor	2
Titulli i trajnimit	Aplikimi i EC0, EC1 dhe EC3 në fazat e projektimit
Përshkrim i shkurtër	Ky trajnim trajton aplikimin praktik të Eurokodeve EC0, EC1 dhe EC3 në fazat e projektimit strukturor. Fokus i veçantë i kushtohet parimeve bazë të projektimit sipas gjendjeve kufitare (ULS dhe SLS), përcaktimit të veprimeve dhe kombinimeve të tyre, si dhe përdorimit të faktorëve parcialë të sigurisë. Në kuadër të trajnimit paraqitet procesi i projektimit nga identifikimi i ngarkesave sipas EC1, aplikimi i kombinimeve sipas EC0, deri te verifikimi i kapaciteteve mbajtëse dhe kriterëve të shfrytëzueshmërisë. Theks i veçantë i kushtohet zbatimit praktik të këtyre parimeve në projekte reale. Gjithashtu, trajtohen konceptet bazë të projektimit të strukturave të çelikut sipas EC3, duke përfshirë rezistencën, stabilitetin dhe dimensionimin e elementeve strukturore në përputhje me kërkesat e standardeve evropiane.
Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Prof. Asst. Dr. Florim Grajçevci; Dr. Sc. Anita Gjukaj
Numri rendor	3
Titulli i trajnimit	Menaxhimi i integruar i rrezikut nga vërshimet, ne kushtet e ndryshimeve klimatike
Përshkrim i shkurtër	Ky trajnim trajton menaxhimin e integruar të rrezikut nga vërshimet në kushtet e ndryshimeve klimatike, të cilat po ndikojnë në rritjen e frekuencës dhe intensitetit të ngjarjeve ekstreme hidrometeorologjike. Fokus i veçantë i kushtohet qasjeve bashkëkohore për reduktimin e rrezikut përmes kombinimit të masave strukturore dhe jostrukturore. Trajtohen ndërhyrjet inxhinierike, si rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe ndërtimi i strukturave mbrojtëse, si dhe instrumentet planifikuese dhe menaxheriale, përfshirë hartëzimin e zonave të rrezikuara, planifikimin hapësinor dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm. Gjithashtu, theksohet rëndësia e menaxhimit në nivel të pellgut ujëmbledhës dhe koordinimit ndërinstytucional. Në këtë kuadër, trajtohen edhe sfidat specifike në Kosovë dhe nevoja për planifikim më të avancuar dhe investime të qëndrueshme në infrastrukturë dhe sisteme monitorimi.
Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale

Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Prof. Dr. Laura Kusari
Numri rendor	4
Titulli i trajnimit	Themelet e thella – Tipologjia, aplikimi dhe zgjidhjet në kushte të vështira gjeoteknike
Përshkrim i shkurtër	Ky trajnim ofron një pasqyrë mbi konceptin, tipologjinë dhe aplikimin praktik të themeleve të thella në inxhinierinë e ndërtimit. Trajtohen nocionet bazë dhe dallimi ndërmjet themeleve të cekëta dhe atyre të thella, si dhe kriteret kryesore për përzgjedhjen e tyre në projekte të ndryshme inxhinierike. Prezantohet tipologjia kryesore e themeleve të thella, përfshirë pilotat, pusët dhe kesonët, së bashku me karakteristikat dhe fushat e përdorimit. Gjithashtu, shpjegohet mekanizmi i transferimit të ngarkesave nga struktura në tokë dhe kushtet tipike të aplikimit, veçanërisht në toka të dobëta dhe në prezencë të ujërave nëntokësore. Në këtë kuadër, trajtohen edhe metodat e vlerësimit dhe testimit të kapacitetit mbajtës në terren, përfshirë provat statike dhe dinamike, si dhe rëndësia e tyre për verifikimin e performancës dhe sigurisë së themeleve në kushte reale.
Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Dr. Sc. Guxim Rrudhani
Numri rendor	5
Titulli i trajnimit	Menaxhimi dhe Mirëmbajtja e Infrastruktues Rrugore dhe Përdorimi i Materialeve Moderne në Ndërtimin e Rrugeve
Përshkrim i shkurtër	Ky trajnim trajton menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore, me fokus në përdorimin e sistemeve moderne për vlerësimin e gjendjes së rrugëve, si Pavement Management System (PMS). Theksohet rëndësia e mirëmbajtjes preventive si qasje efikase për zgjatjen e jetës shërbyese të rrugëve dhe reduktimin e kostove të rehabilitimit. Gjithashtu, prezantohen zhvillimet bashkëkohore në materialet ndërtimore dhe aplikimi i tyre në praktikë, përfshirë asfaltin e modifikuar me polimere, materialet gjeosintetike dhe zgjidhjet inovative në shtresat rrugore, të cilat kontribuojnë në rritjen e qëndrueshmërisë dhe performancës së infrastrukturës. Në këtë kuadër, trajtohet edhe roli i teknologjive të avancuara dhe kontrollit të cilësisë gjatë ndërtimit dhe mirëmbajtjes, si faktorë kyç për sigurimin e performancës dhe jetëgjatësisë së rrugëve.
Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Inxh. Dipl. Florije Pajaziti; MSc. Zejnepe Morina
Numri rendor	6

Titulli i trajnimit	Piketimi dhe kontrolli gjeodezik i ndërtimit dhe monitorimi i deformimeve dhe stabilitetit të objekteve
Përshkrim i shkurtër	Ky trajnim trajton metodat e piketimit dhe kontrollit gjeodezik gjatë procesit të ndërtimit, për objekte lineare dhe komplekse. Fokus i veçantë i kushtohet kontrollit të devijimeve gjatë ndërtimit, analizës së tyre dhe sigurimit të saktësisë në realizimin e projekteve, si dhe përgatitjes së planeve “as-built”. Gjithashtu, prezantohen metodat klasike dhe bashkëkohore për monitorimin e deformimeve dhe stabilitetit të objekteve, përfshirë projektimin e sistemeve të monitorimit, analizën statistikore të lëvizjeve dhe vlerësimin e rezultateve në kushte reale. Trajtohen edhe kompensimi i rrjetit dhe identifikimi i deformimeve në struktura. Në këtë kuadër, paraqiten raste tipike të aplikimit gjeodezik, si në diga, ura dhe zona të prekura nga rrëshqitjet e tokës, duke theksuar rëndësinë e monitorimit të vazhdueshëm për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e objekteve.
Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Prof. Asoc. Dr. Bashkim Idrizi

1.3 Fushat profesionale dhe temat e trajnimeve në inxhinierinë elektroteknike

Numri rendor	1
Titulli i trajnimit	Menaxhimi dhe Mirëmbajtja e Sistemeve Elektroenergjetike
Përshkrim i shkurtër	Ky trajnim trajton menaxhimin dhe mirëmbajtjen efektive të sistemeve elektroenergjetike (SEE), duke përfshirë prodhimin, bartjen dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Fokus i veçantë i kushtohet menaxhimit operativ në kushte normale të operimit dhe strategjive të mirëmbajtjes së pajisjeve kryesore. Trajtohen qasjet e mirëmbajtjes preventive, planifikimi dhe monitorimi i gjendjes së pajisjeve si transformatorët, linjat dhe ndërprerësit. Gjithashtu, analizohet identifikimi dhe minimizimi i humbjeve teknike në rrjetet transmetuese dhe shpërndarëse dhe ndikimi i tyre në efikasitetin e sistemit. Në këtë kuadër, prezantohen edhe raste praktike nga operimi i sistemeve elektroenergjetike, duke përfshirë analizën e ndërprerjeve dhe identifikimin e shkaqeve, si dhe diskutim interaktiv me pjesëmarrësit.
Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Dr. Sc. Armend Ymeri
Numri rendor	2
Titulli i trajnimit	Digjitalizimi i Rrjetit

Përshkrim i shkurtër	Ky trajnim trajton digjitalizimin e sistemeve elektroenergjetike (SEE), duke përfshirë përdorimin e teknologjive të avancuara si SCADA, Smart Grid dhe sensorët inteligjentë për monitorim, menaxhim dhe optimizim të sistemit. Fokus i veçantë i kushtohet konceptit dhe rëndësisë së digjitalizimit, kalimit nga rrjetet tradicionale në rrjete inteligjente, si dhe sfidave dhe përfitimeve që lidhen me këtë transformim. Gjithashtu, prezantohen teknologjitë kryesore për monitorim në kohë reale, automatizim dhe kontroll të proceseve. Në këtë kuadër, trajtohen edhe raste praktike nga operimi i sistemeve elektroenergjetike, përfshirë analizën e ndërprerjeve, identifikimin e shkaqeve dhe përmirësimin e reagimit dhe rikthimit të furnizimit, të shoqëruara me diskutim interaktiv me pjesëmarrësit.
Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Inxh. Dipl. Elek. Drenusha Gashi; Inxh. Dipl. Elek. Nezir Neziri
Numri rendor	3
Titulli i trajnimit	Energjia e Ripërtëritshme, Integrimi i Burimeve të Ripërtëritshme dhe Ndikimi në Stabilitetin e Rrjetit
Përshkrim i shkurtër	Ky trajnim trajton integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (diellore, erë, hidro dhe biomasa) në rrjetin elektrik, me fokus në ndikimin e tyre në stabilitetin dhe besueshmërinë e sistemit elektroenergjetik. Trajtohen parimet bazë dhe rëndësia e energjisë së ripërtëritshme, si dhe roli i saj në qëndrueshmërinë energjetike dhe reduktimin e emetimeve. Gjithashtu, prezantohen qasjet për integrimin e këtyre burimeve në rrjet, përfshirë parashikimin e prodhimit, balancimin e ngarkesave dhe përdorimin e teknologjive si Smart Grid, SCADA dhe sistemet e menaxhimit të energjisë. Në këtë kuadër, analizohen sfidat teknike gjatë integrit, veçanërisht ndikimi në tension, frekuencë dhe humbjet në rrjet. Trajnimi përfshin edhe raste praktike të operimit të rrjetit, me fokus në variabilitetin e prodhimit dhe rikthimin e stabilitetit, të shoqëruara me diskutim interaktiv.
Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Dr. Sc. Armend Ymeri; Dr. Sc. Vehbi Sofiu

1.4 Fushat profesionale dhe temat e trajnimeve në inxhinierinë mekanike

Numri rendor	1
Titulli i trajnimit	Integrimi i Sistemeve Mekanike dhe Automatizimi Industrial
Përshkrim i shkurtër	Ky trajnim trajton integrimin e sistemeve mekanike me teknologjitë e automatizimit industrial, me qëllim rritjen e

	efikasitetit, besueshmërisë dhe fleksibilitetit të proceseve prodhuese në përputhje me konceptet bashkëkohore të industrisë. Fokus i veçantë i kushtohet parimeve të mekatronikës dhe integritit sistemor, komponentëve të automatizimit (sensorë, aktuatorë, PLC), si dhe sistemeve të monitorimit dhe kontrollit (SCADA). Gjithashtu, trajtohen komunikimi industrial, robotika dhe integrimi me teknologjitë IoT dhe Industry 4.0. Në këtë kuadër, prezantohen qasje për analizën, simulimin dhe optimizimin e proceseve industriale, si dhe aspektet e sigurisë funksionale dhe standardeve përkatëse. Trajnimi përfshin edhe raste praktike nga industria dhe aplikimin e mjeteve softuerike për automatizim dhe kontroll.
Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Prof. Dr. Arbnor Pajaziti
Numri rendor	2
Titulli i trajnimit	Projektimi, Certifikimi dhe Mirëmbajtja e Ashensorëve
Përshkrim i shkurtër	Ky trajnim trajton projektimin, kontrollin teknik, certifikimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të transportit vertikal, me fokus në përputhjen me standardet evropiane dhe kërkesat për siguri dhe funksionim të besueshëm. Fokus i veçantë i kushtohet bazave të projektimit dhe tipologjive të ashensorëve, si dhe interpretimit dhe zbatimit të standardeve dhe rregullativës teknike përkatëse. Gjithashtu, trajtohen procedurat e inspektimit dhe certifikimit, si dhe menaxhimi i mirëmbajtjes dhe rrezikut operacional. Në këtë kuadër, prezantohen metodat e diagnostikimit dhe analizës së defekteve, aspektet e sigurisë funksionale (EN 81), si dhe zgjidhjet bashkëkohore për monitorim në distancë dhe digitalizim. Trajnimi përfshin edhe raste praktike nga proceset e inspektimit dhe certifikimit.
Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Do të caktohen në kohë, në përputhje me ekspertizën
Numri rendor	3
Titulli i trajnimit	Projektimi i Sistemeve HVAC sipas Standardeve Evropiane dhe Efikasiteti Energjetik
Përshkrim i shkurtër	Ky trajnim trajton projektimin dhe optimizimin e sistemeve HVAC në përputhje me standardet evropiane dhe kërkesat për efikasitet energjetik dhe qëndrueshmëri. Fokus i veçantë i kushtohet dimensionimit të sistemeve bazuar në ngarkesat termike dhe përzgjedhjes së zgjidhjeve me performancë të lartë. Trajtohen sistemet bashkëkohore HVAC, përfshirë pompat e nxehtësisë, sistemet VRF dhe chiller, si dhe teknologjitë për rikuperimin e energjisë dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit të brendshëm.

	Gjithashtu, prezantohet roli i automatizimit (BMS/SCADA) dhe simulimit energjetik në analizën dhe optimizimin e performancës së sistemeve. Në këtë kuadër, trajtohet optimizimi i konsumit energjetik, auditimi i sistemeve dhe integrimi me burime të rinovueshme të energjisë, si dhe paraqiten raste praktike nga projekte reale HVAC.
Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Prof. Dr. Shaqir Elezaj
Numri rendor	4
Titulli i trajnimit	Infrastruktura Moderne e Transportit
Përshkrim i shkurtër	Ky trajnim trajton planifikimin, projektimin dhe menaxhimin e infrastrukturës moderne të transportit, duke integruar teknologjitë inteligjente dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Fokus i veçantë i kushtohet analizës së sistemeve të transportit dhe interpretimit të rrjeteve dhe flukseve të trafikut. Trajtohen qasjet bashkëkohore në modelimin e trafikut, mobilitetin urban dhe konceptet e “smart cities”, si dhe integrimi i sistemeve inteligjente të transportit (ITS). Gjithashtu, prezantohen aspektet e sigurisë rrugore, ndikimet mjedisore dhe roli i transportit të qëndrueshëm dhe elektrifikimit. Në këtë kuadër, trajtohet menaxhimi i projekteve infrastrukturore dhe modelet e financimit, përfshirë partneritetet publiko-private (PPP), si dhe paraqiten raste praktike nga projektet reale.
Mënyra e mbajtjes	Me prezencë fizike
Numri total i minutave	90 minuta nga fusha profesionale
Numri i pikëve kredituese	3
Ligjëruesit:	Do të caktohen në kohë, në përputhje me ekspertizën

Neni 7

Ky program hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij dhe do të publikohet në faqen e internetit të Odës.

Prishtinë: 07 prill 2026

Kryetari i Odës së inxhinierëve të Republikës së Kosovës

Arsim Rapuçi

